Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0377

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani Kryetare, Agon Ramadani Referues, Vedat Poterqoi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa ", kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të POLICIA E KOSOVËS në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pjese per automjetet Shkoda Rapid –të me numër të prokurimit 214-23-1137-1-1-1, me 09/10/2023, mori:

Vendim

I. Aprovohet pjesërisht, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë Buqa " Sh.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 09.06.2023 (me numër protokolli 377/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pjese për automjetet Shkoda Rapid-te" me nr. të prokurimit: "214-23-1137-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Policia e Kosovës .

II. Ndërkaq aktiviteti i larte cekur kthehet ne **rivlerësim.**

III.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- *Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 02.03.2023, Policia e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pjese për automjetet Shkoda Rapid-te" me nr. të prokurimit: "214-23-1137-1-1-1". Ndërkaq me datën 22.05.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE "Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë" shpk me datën 29. 05. 2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Me datën 02. 06. 2023, AK- Policia e Kosovës me vendim ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues "Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë" shpk, me datën 09.06.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 377/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 550.000.00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 21.06.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet si e bazuar
- Ndërkaq aktiviteti i larte cekur kthehet ne rivlerësim.

Sqarim Hyrës

Grupi i OE ankues, i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt. 31.03.2023 paraqet ankesë në OSHP me pretendime të njëjta ankimore duke shtuar edhe pretendime lidhur me arsyeshmerinë e vendimit të AK- së

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES

<u>Përgjigje në Pretendimin nr.1</u>

Lidhur me pretendimin e pare qe ka te beje me kërkesën e përshtatshmërisë profesionale 9.1 & 9.2 a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 400,000.00 €

Dëshmia: a) Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontrate) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. <u>Referencat ose fletët pranimet në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit të furnizimeve</u>. Vërejtje: Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e

bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e furnizimeve ose raportet e flete pranimeve te furnizimeve kur furnizimi është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen fletëpranimet ose referencat (ne referenca te jete e cekur vlera e furnizimeve, shërbimeve ose punëve) te lëshuara nga autoriteti i tillë

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë me ofertën e tij ka dorëzuar listën e kontratave në te cilën pjesë e asaj liste është edhe kontrata "Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtja e makinerisë se rëndë (buldozerëve) me nr. KMDK-19-4022-1-1-1 ne vlere **394,361.81 €.**

OE i rekomanduar për kontratë për kontratën në fjalë nuk i kishte bashkangjitur ***"referencat apo fletëpranimet e nënshkruara"*** sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit 9.1 & 9.2.

AK-ja me datën 14.04.2023 ka dërguar kërkesë për sqarim ku kërkon sqarime për origjinën e disa produkteve, çmimet dhe ne piken e dytë kërkon dorëzimin e referencave sipas listës se dorëzuar me ofertë me afat te kthimit te përgjigjes deri me 19.04.2023.

OE i dërgon përgjigjet me datën 19.04.2023 ku si dëshmi përfshin urdhëresa pune dhe fatura nga kontrata me nr. KMDK 19 4022 111 si me lartë. OE prapë me datën 02.05.2023 dërgon një komunikim te AK-ja me kontraktuesin ku ne kërkesën për **"dëshmi se çdo gjë ka shkuar ne rregull me kontratën**" e merr një konfirmim përmes emailit se **"kontrata ka shkuar ne rregull"**.

AK-ja ka dërguar prapë kërkesë për sqarim me datën 04.05.2023 me kërkesën e njëjtë për referenca dhe fletëpranime sipas kërkesës se dosjes si me lartë. Afati për përgjigje në kërkesë deri me 05.05.2023.

OE i dërgon përgjigjet me datën 04.05.2023 ku përfshin **"fatura dhe pranime pune"** për kontratën ne fjalë te cilat nuk i kishte dërguar ne kërkesën e datës 14.04.2023.

Eksperti shqyrtues ne baze te kërkesës për sqarim nga AK te datës 19.04.2023 ka kërkuar sqarime nga AK-ja me kërkesën e datës 21.06.2023 ne lidhje me komunikimin e OE te rekomanduar për kontratë si me poshtë:

"Në sqarimet e dhëna nga OE i rekomanduar për kontratë është dorëzuar një email i kërkuar nga zyrtarja e OE A.F për përfaqësuesin e kontratës se realizuar KMDK M.T si dhe përgjigja e te njëjtit. Ju lutem te me ofroni dëshmi se kur është dërguar kërkesa dhe kur është pranuar përgjigja nga M.T, pra me duhen datat e komunikimit."

- AK-ja ne përgjigjen e saj dërgon komunikimin e datës 02.05.2023 te zyrtares se AK-se H.Z dhe përgjigjen e zyrtarit M.T te datës 03.05.2023.

- Për me tepër dëshmia e dërguar nga OE i rekomanduar për kontrate është dërguar pas afatit te kërkesës (02.05.2023) në të cilën nuk janë përfshirë datat e komunikimit.

- Në kërkesën për sqarime janë kërkuar edhe kontratat për disa pozicione. E njëjta nuk është kërkuar për OE Toverlani me referencën prej **45,267.48** te datës 01.08.2021 për te vërtetuar se a është kontratë e përfunduar. AK-ja e ka llogaritur ne listën e kontratave te realizuara.

- Poashtu AK gjatë përllogaritjes se pranimeve nuk i ka marre parasysh liferimit te cilat nuk hyjnë periudhën prej tri vitet e fundit nga data e njoftimit te kontratës.

OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar fletëpranime te cilat ne kerkese per sqarime i ka emërtuar "pranime pune ".

- Eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar i cili përben 80% te dëshmive sipas nenit 9.1 dhe 9.2 nuk e plotëson kërkesën 9.1 & 9.2 te dosjes se tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se gjate kërkesës për sqarime shtesë AK-ja nuk ka vepruar ne përputhje me nenin 59 paragrafi 2 te LPP- së k amini i, le ë imi d e K a a imi i en e ë e, Neni 69 ë ia e nike d e/ose o e io ale si dhe

1. Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Paragrafi 1 Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Rrjedhimisht eksperti shqyrtues vlerëson se **pretendimi ankimor është i bazuar.**

<u>Përgjigje në Pretendimin nr. 2</u>

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me origjinën e produkteve eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontrate me ofertën e tij ka dorëzuar edhe origjinën e produkteve te cilën e ka dorëzuar edhe pas kërkesës për sqarim te tenderit me datën 02.06.2023.

Ne sqarim ka dorëzuar edhe certifikatën përkatëse nga prodhuesi i cili dëshmon se produktet e prodhuara janë ne përputhje me standardet.

Eksperti shqyrtues vlerëson se te gjitha kompanitë e mëdha botërore sot e kanë linjën e prodhimit ne Kinë duke mos humbur cilësinë dhe brand kështuqë çështja e origjinës dhe kualitetit të produkteve është çështje e rregulluar me kontratë me kushtet e përgjithshme neni 3 dhe kushtet e veçanta neni 16.2.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor për këtë pikë **nuk është i bazuar.**

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues-

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se raporti i ekspertit nuk ka gjetur mbështetje të plotë nga ana e PSH për arsyet që do të shtjellohen si më poshtë. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave

publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel.

Lidhur me ankesën si objekt shqyrtimi në relacion me pretendimet ankimore të parashtruara në këtë ankesë, PSH deri tek vendim-marrja përfundimtare ka arritur duke konsideruar pikën kyçe përcaktuese të cilat kanë orientuar drejt vendimit sikur në dispozitiv, çështja përcaktuese është konsideruar çështja e ngritur nga ana OE ankues me çrast ka pretenduar i njejti nuk ka plotësuar kërkesën lidhur me kontratat e ngjashme të përfunduara, konkretisht pretendimet e ndara nga ana e ekspertit, të paraqitura me nr rendor 1.

Vlen të theksohet se lidhur me kërkesën ne fjalë, paneli shqyrtues duke u bazuar në provat dhe argumentet e paraqitura ka konsideruar elementet kryesore të rrjedhës së këtij aktiviteti që janë vlerësimi i ofertave në relacion me kontratat e paraqitura nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, ku në bazë të të gjeturave të ekspertit dhe provave të paraqitura në këtë procedurë rezulton që OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar listën e kontratave në te cilën pjesë e asaj liste është edhe kontrata "Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtja e makinerisë se rëndë (buldozerëve) me nr. KMDK-19-4022-1-1-1 ne vlere 394,361.81 €,e cila mund të konsiderohet si kontrata kryesore në listën e dorëzuar për shkak të vlerës së saj në raport me kontratat tjera, që në rast mos konsiderimi të kësaj kontrate nga ana e AK-së OE i rekomanduar do të mund të cilësohej si OE i papërgjegjshëm, lidhur me rrjedhën e rrethanave të zhvilluara në raport me vlerësimin e ofertave nga ana e AK-së lidhur me kontratën e njëjtë është evidentuar se AK ka kërkuar sqarime nga ana e OE të rekomanduar lidhur me referencën, poashtu lidhur me përfundimin e së njëjtës me ç 'rast OE ankues ka paraqitur faturat e shitjes mbi shërbimet dhe furnizimet e kësaj kontrate po ashtu një komunikim nga AK i asaj kontrate që e "njëjta ka përfunduar në rregull".

Ndërsa çështja kryesore e evidentuar si objekt shqyrtimi i kësaj ankese ka qenë mënyra e vlerësimit të ofertave nga ana e komisionit në aspektin e ngjashmërisë së kontratave, ku në rastin konkret duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura nga palët në relacion me pretendimin e ngritur nga ana e OE ankues se kontrata në fjalë nuk mund të konsiderohet e ngjashme për faktin se ka përmbajtur shërbime në masë të madhe si dhe jo furnizime siç është aktiviteti në fjalë si dhe kërkesa në DT. Bazuar në rrjedhën e këtij aktiviteti mund të arrihet në vlerësimin se AK lidhur me këtë kontratë ka llogaritur shërbimet si dhe furnizimet e kryera nga ana e OE të rekomanduar me ç'rast nga vlera totale e saj (394,361.81 €) pas llogaritjeve të shërbimeve dhe të furnizimeve janë vlerësuar si të pranueshme vlera prej rreth 300,000 €, ndërsa bazuar në kalkulimet e ekspertit shqyrtues vlera e pranueshme e furnizimeve ka qenë rreth 219.000 € për kontratën e njëjtë si rrjedhoje duke mos kaluar pragun e kërkuar duke mos e plotësuar kërkesën relevante, lidhur me këtë çështje PSH konstaton se në aspektin se si duhet të trajtohen kontratat e natyrës së njëjtë legjislacioni në fuqi saktëson se klasifikimi i tyre mund të përcaktohet fillimisht duke u nisur nga kodi i prokurimit si dhe klasifikimi i tij si furnizim apo shërbim apo punë , Për me tepër bazuar në neni 14.7 i Rregullores për Prokurimin Publik përcakton : "Për një kontratë publike që mund të jetë "kombinim": Furnizim/Shërbim, Punë/Shërbim; Punë/Furnizim; kombinim në Furnizim/Punë/Shërbime, metoda bazike për të trajtuar këtë ndarje është gjithnjë modeli i kostos së thjeshtë. Cilido element i kontratës që ka shpenzimet më të larta të parashikuara kontrata duhet të klasifikohet nën atë lloj të kontratës....". Vlen të shtohet po ashtu se KRPP me datë 09.06.2023 ka publikuar opinion ligjor nr. 11 lidhur me pyetjen "Cili është përkufizimi i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?" me çrast shpjegohet se: *Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast*

si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.. Poashtu lidhur me ndarjen e kontratave, faturave apo situacioneve tek kontratat bazike lidhur me përfundimin e tyre kemi interpretim ligjor nga KRPP, konkretisht pyetja nr 10 "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet? , ndërsa në përgjigjje ndër të tjera theksohet se:

Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet.

Në rastin konkret kontrata bazuar në numrin e prokurimit ka qenë kontratë "furnizim" e poashtu kërkesa e aktivitetit relevant si dhe vet aktiviteti në bazë të kodit është kontratë "furnizim",

Lidhur me këtë çështje PSH arrin në konstatim se përderisa vlerësimi i ofertave është bërë duke ndarë furnizimet nga shërbimet si dhe duke dalluar vlerën e tyre, PSH poashtu vlerëson se me qenë se kjo çështje nuk specifikohet në mënyrë decidive në legjislacionin në fuqi, ndërsa në opinionet dhe dispozitat e referuara si më lartë mund të arrihet në konstatimin se situatat e referuara përmbajnë ngjashmëri dhe mund të aplikohen në rastin konkret, por në të njëjtën kohë legjislacioni e poashtu kërkesat në NJK dhe DT gjithmonë i referohen "kontratës" si tërësi, e poashtu duke u bazuar në praktikat e deri-tanishme si dhe tiparet themelore të LPP-së, PSH konstaton se lidhur me këtë çështje AK në bazë të dokumentacionit të paraqitur (kontratave) mund të konsiderojë apo jo një kontratë si tërësi, që do të thotë vlerën totale, e jo duke ndarë të njëjtën si dhe duke pranuar atë pjesërisht.

Sa i përket aplikimit të sqarimit/informatave shtesë lidhur me referencën, si çështje e ngritur, PSH konstaton se lidhur me këtë, legjislacioni në fuqi rregullon rastin specifik, konkretisht Udhëzuesi Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik, neni 10.1 saktëson se në rastet kur : *Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara,* përcaktohet që, *Mund të kërkohen informata sqaruese* konform neneve 72 dhe 59 të LPP-së, andaj veprimi i ndërmarrë nga ana e AK-së duke kërkuar sqarime lidhur me referencat si pjesë e listës së kontratave në ofertën e OE të rekomanduar konsiderohet se është në harmoni me këtë dispozitë.

Lidhur me pretendimin nr 2, PSH konstaton se mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues profesional të dhënë në raportin e ekspertizës, kështu që rrjedhimisht ky pretendim klasifikohet si i pa-bazuar.

Andaj përfundimisht lidhur me këtë çështje është arritur në vendimin përfundimtar siç i shtjellua si më sipër, që rrjedhimisht ka rezultuar që nga ana e panelit u konsiderua se aktiviteti duhet të kthehet në rivlerësim si dhe rivlerësimi të bëhet duke vlerësuar kontratat si kontrata të plota dhe jo të ndara, duke pranuar apo mos pranuar të njëjtat në tërësi bazuar në kërkesën e DT dhe legjislacionit në fuqi, e poashtu në rast të mungesës së informacionit lidhur me përfundimin, referencën dhe informacionet tjera të aplikojë dispozitat rregulluese të neneve 72 dhe 59 të LPP-së, dhe bazuar në të gjeturat të dalë me vendim përfundimtar.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "**
- Arkivës së OSHP-së: